



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:920287

Datë: 14.05.2021

Numri i dokumentit: 01777550

**Ae.nr.98/21**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Mahir Tutuli dhe Rrustem Thaqi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses N.T.”[M...]” me seli në Prizren, të cilën e përfaqëson me autorizim avokati “[V.R]” nga Prishtina, kundër të paditurës NTP “[B...]” me seli në Ferizaj, të cilën e përfaqëson me autorizim avokati “[F.L]” nga Prishtina, për kompensim dëmi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike I.EK.nr.689/20 e datës 31/03/2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **05/05/2021**, mori këtë:

#### **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** e pa themeltë ankesa e paditëses N.T. “[M...]” me seli në Prizren dhe **VËRTETOHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike I.EK.nr.689/20 e datës 31/03/2021.

#### **A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin ankimor I.EK.nr.689/20 e datës 31/03/2021, ka vendosur që të konstaton se paditësja N.T.”[M...]” me seli në Prizren, e ka tërhequr padinë në këtë çështje kontestimore si dhe ka detyruar paditësen N.T.”[M...]” me seli në Prizren, që të paditurës NTP “[B...]” me seli në Ferizaj, t’ia paguaj shumën prej 405,00 euro, në emër të kompensimit të shpenzimeve procedurale të bëra në gjykimin e parë, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktvendimi, paditësja në afatin ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa si e bazuar ndërsa aktvendimi i atakuar të ndryshohet dhe çështja të kthehet në rigjykim.

E paditura nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 lidhur me nenin 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

**-Ankesa është e pa themeltë.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja N.T.”[M...]” me seli në Prizren, pran Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me datën 11/04/2017, ka paraqitur padi për kompensim dëmi, kundër të paditurës N.T.”[M...]” me seli në Prizren, me kërkesë të përshkruar si në petitumin e padis.

Gjykata e shkallës së parë në aktvendimin ankimor mes tjerash ka arsyetuar se paditësja me parashtresën e datës 24/02/2021 e ka tërhequr padinë në këtë çështje kontestimore dhe mbi bazën e kësaj gjendje të konstatuar, ka vendosur si në dispozitivin e aktvendimit të atakuar duke u bazuar në nenin 261.2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit të pathemelta qëndrojnë pretendimet ankimor të paditëses, për arsye se ishte jo kontestuese fakti se paditësja me parashtresën e datës 22/02/2021 e ka tërhequr padinë ndërsa i autorizuari i të paditurës në seancën e datës 30/03/2021 e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padis dhe njëkohësisht i ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore të precizuara si në parashtresën e datës 21/03/2021 e që kanë të bëjnë me përpilimin e përgjigjes në padi si dhe me përfaqësimet e të paditurës në seanca gjyqësore. Sipas nenit 261.2 të LPK-së është paraparë: *Padia mund të tërhiqet*

*edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë.*

I drejtë del te jetë edhe vendimi për shpenzimet e procedurës, pasi që shpenzimet e njohura janë në përputhje të plotë me shpenzimet që i njëjti i ka pasur rreth përfaqësimit të tij në procedurë dhe kanë qenë të nevojshme për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike. Sipas nenit 456.1 i LPK-së është paraparë: *Paditësi që e tërheqë padinë ka për detyrë që të paditurit t'ia shpërblej shpenzimet procedurale përveçse kur tërheqjen e padisë e ka bërë menjëherë pas përmbushjes së detyrimit nga ana e të paditurit.*

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktvendimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, që do të ndikonte në ligjshmërinë e aktvendimit, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 208, nenit 209, par.1 pika b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**-Departamenti për Çështje Ekonomike-**  
**Ae.nr.98/21, me datën 05/05/2021**

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari  
Liridon Maloku